

LEKSIONI 2

PËRBËRËSIT E FRAZËS (SINTAGMAT)

Cështjet :

1. *Fraza.*
2. *Natyra e përbërësve dhe kriteret për dallimin e tyre.*
3. *Kategoritë e ndryshme të përbërësve.*

1. Fraza

Termi frazë në sintaksën e sotme ka marrë shumë kuptime. Përveç fjalisë, me frazë, në gjuhësinë e sotme, sidomos në atë amerikane, emërtohen edhe grupet e fjalëve apo edhe një fjalë e vetme. Këtu, me këtë term do të emërtojmë përgjithësisht fjalinë.

Këtu do të tregojmë se si grupet e fjalëve formojnë frazën (pra, janë përbërësit e saj), se si këta përbërës janë formuar nga përbërës të tjerë deri në fjalët e vetme që janë përbërësit fundorë.

Përbërësit ose grupet e fjalëve quhen ndryshe *sintagma* (nga greq. “*syntagma*” që do të thotë *vendosje, rreshtim*). Përbërësit ose sintagmat janë të madhësive të ndryshme, nuk ka kufizime në përcaktimin e vëllimit të tyre, që nga përbërësit e një madhësie më të lartë deri tek fjalët e vetme.

Sintagmat janë kategori sintagmatike, kurse fjalët kategori leksikore.

Grupet e fjalëve formojnë realisht fjalinë dhe kjo do të përcaktohet mbi bazën e kriterëve të qarta.

2. Natyra e përbërësve dhe kriteret për dallimin e tyre

Është e pamundur të bëjmë një analizë të saktë sintaksore duke supozuar se frazat janë ndërtuar vetëm nga fjalët, prandaj është e domosdoshme të pranojmë

ekzistencën e pjesëve të ndërmjetme midis fjalëve e frazave, d.m.th., të grupeve të fjalëve. Pra, jo vetëm fjalët e vetme, po edhe ato të bashkuara në grupe, mund të kryejnë të njëjtin funksion. P.sh, në të dyja frazat:

- *Erioni është nisur,*
- *Djali i fqinjit tim të katit të katërt është nisur,*

fjalët e nënvizuara kryejnë funksionin e kryefjalës. Kjo lloj analize tregon për një përdorim pak a shumë të ndërgjegjshëm të grupit të fjalëve.

Edhe thjeshtë nga ana intuitive, po t'i shohim frazat, rezulton se ato nuk janë pasime të thjeshta të fjalëve të veçuara, por janë të përbëra prej fjalësh hierarkisht të renditura.

Fraza:

- *Përshëndeta njeriun me lule*

është një tip i frazës së dykuptimshme. Ajo mund të interpretohet si:

- *përshëndeta një njeri me lule (me anë të luleve, duke ia tundur lulet nga larg, bie fjala)*
dhe
- *përshëndeta një njeri me lule (pra, një njeri që mbante lule).*

Kjo lloj **dykuptimësie** quhet strukturore, sepse ka dy mënyra të ndryshme për rigrupimin e fjalëve në këtë frazë, pra, dy struktura të mundshme në përbërës që kanë të bëjnë me dy interpretime të ndryshme.

Në qoftë se fjalët *me lule* nuk i grupojmë me fjalën *njeriu*, atëherë kuptimi i frazës është : përshëndeta një njeri me një mjet që quhet lule.

Në qoftë se këto fjalë i grupojmë me fjalën *njeriu*, atëherë kuptimi i frazës nuk ka të bëjë me mjetin e kryerjes së veprimit, por me faktin se njeriu që përshëndeta mbante lule.

Natyrisht, konteksti jashtëgjuhësor e zgjidh problemin e dykuptimësisë, por ajo që na intereson të nënvizohet këtu, është se një dykuptimësi e tillë është një prej karakteristikave më tipike të gjuhës njerëzore.

Në rastin tonë të dyja kuptimet e frazës nuk dallohen fonologjikisht, mbasi nuk ka dy mënyra të ndryshme për të artikuluar frazën. Pra, çështja e dykuptimësisë ka të bëjë me fakte thjesht sintaksore: frazat përbëhen nga grupe fjalësh e se këto grupe fjalësh mund të grupohen nga ana e tyre në mënyra të ndryshme. Ky strukturim i frazës nuk është menjëherë i dukshëm dhe i kapshëm.

Atëherë duhen vendosur kritere për të përcaktuar nëse një varg fjalësh formon një përbërës apo jo. Këto kritere janë:

1. **Kriteri i lëvizjes.** Në qoftë se një varg i dhënë fjalësh formon një përbërës, ai mund të zhvendoset në vende të ndryshme brenda frazës. Kështu, në frazën (4) vargu i fjalëve në muzeun e qytetit formon një përbërës, sepse mund të zërë pozicione të tjera, siç tregojnë shembujt e tjerë më poshtë.

- (4) a. Valbona shkoi javën e kaluar në muzeun e qytetit.
- b. Në muzeun e qytetit Valbona shkoi javën e kaluar.
- c. Valbona në muzeun e qytetit shkoi javën e kaluar.
- d. Valbona shkoi në muzeun e qytetit javën e kaluar.

Kriteri i lëvizjes na bind se edhe seria e fjalëve javën e kaluar mund të konsiderohet si përbërës, sepse edhe ajo mund të shfaqet në pozicione të ndryshme brenda frazës, por asnjëherë brenda vargut në muzeun e qytetit :

- (5) *Valbona shkoi në muzeun javën e kaluar e qytetit

2. **Pamundësia e ndërtimit të një strukture** si fjalia (5) përbën një tjetër kriter për përcaktimin e përbërësve, ***kriterin e mosndërfutjes*** së elementeve të tjera brenda tyre. Pra, një varg fjalësh përbën një përbërës nëqoftëse nuk mund të ndërpritet nga ndërhyrja e përbërësve të tjerë. Nga kjo del se grupet e fjalëve sillen në të njëjtën mënyrë si edhe fjalët. Në qoftë se një nga vetitë e fjalës është se ajo mund të zërë pozicione të ndryshme brenda fjalisë, tipare të tilla shfaqin edhe grupet e fjalëve.

3. **Një kriter tjetër është ai i përdorimit të një përbërësi si një thënie me vete** i painkuadruar në një frazë të plotë ose, siç quhet ndryshe, **kriteri i thënies së izoluar**. Në përgjithësi për një pyetje, p.sh, si tek fraza (6a), nuk jepet gjithmonë një përgjigje si të (6b) që del e gjatë dhe e tepërt, po një përgjigje si të (6c):

(6) a. Ku shkoi Valbona javën e kaluar?

b. Valbona javën e kaluar shkoi në muzeun e qytetit.

c. Në muzeun e qytetit.

4. **Kriteri i bashkërenditjes** : dy grupe fjalësh mund të jenë të bashkërenditura vetëm në qoftë se janë përbërës të së njëjtës kategori. Kështu, sekuencat e nënvizuara në fjalitë më poshtë janë përbërës të së njëjtës kategori:

(7) Valbona shkoi javën e kaluar në muzeun e qytetit dhe në shtëpinë ku kishte kaluar fëmijërinë.

(8) Valbona shkoi në muzeun e qytetit javën e kaluar dhe ditën e parë të kësaj jave.

E kundërta ndodh me frazën e mëposhtme, ku një mollë dhe në muzeun e qytetit nuk janë përbërës të së njëjtës kategori:

(9)* Valbona hëngri një mollë dhe në muzeun e qytetit.

Është pikërisht bashkërenditja e dy përbërësve të kategorive të ndryshme që e shkakton jogramatikalitetin në këtë frazë. Këta përbërës nuk mund të bashkërenditen, mbasi u përkasin kategorive të ndryshme. Përbërësit në muzeun e qytetit dhe në shtëpinë ku kishte kaluar fëmijërinë kanë të përbashkët vetëm një element, parafjalën dhe është pikërisht ky element i përbashkët që bën që këto grupe fjalësh t'i përkasin së njëjtës kategori. Këto grupe quhen **grupe parafjalore**. Javën e kaluar dhe ditën e parë të kësaj jave janë dy grupe që lidhen me emrat javë dhe ditë. Ato quhen **grupe emërore**.

5. Karakteri sistematik i lidhjes midis kategorive leksikore dhe kategorive sintagmatike mund të tregohet me kriterin e fundit që shërben për të dalluar

përbërësit që është ai i ***zëvendësimit me anë të një proforme***. Shembull tipik i proformës janë përemrat vetorë që mund të qëndrojnë në vend të grupeve emërore ose parafjalore:

(10) a. Valbona përsëndeti *djalin e saj*.

b. Valbona *e* përsëndeti.

(11) a. Valbona përsëndeti *prindërit e saj*.

b. Valbona *i* përsëndeti.

Gjithsesi duhet të theksojmë se kriteret që paraqitëm më sipër nuk janë të vetmit që shërbejnë për të dalluar përbërësit. Në përgjithësi për të treguar se një grup fjalësh formon një përbërës, kërkohet zbatimi i më tepër se një kriteri, po nga ana tjetër, nuk është gjithmonë e nevojshme të kërkohet ndihmë nga të gjitha ato kriteret.

3. Kategoritë e ndryshme të përbërësve

Përveç dy llojeve të përbërësve, grupit emëror dhe grupit parafjalor që pamë më lart, kriteret e vendosura na lejojnë të njohim edhe tipa të tjerë përbërësish, si : *grupin mbiemëror*, *grupin foljor* dhe *grupin ndajfoljor*. Kriteri i zhvendosjes tregon se një grup fjalësh, si: *shumë i zgjuar*, i formuar nga një mbiemër dhe nga një fjalë që intensifikon ose specifikon kuptimin e tij, sillet si përbërës.

(12) a. Sokoli nuk është *shumë i zgjuar*.

b. *Shumë i zgjuar* Sokoli nuk është.

Rezultate të njëjta jep kriteri i ndërftjes së një elementi. Nuk mund të hyjnë fjalë të tjera ose përbërës të tjerë brenda grupit *shumë i zgjuar*.

(13) a. Sokoli, besoj, nuk është *shumë i zgjuar*.

b. Sokoli nuk është, besoj, *shumë i zgjuar*.

c. *Sokoli nuk është *shumë*, besoj, *i zgjuar*.

Në sintaksë dallohen këta tipa përbërësish :

- *grupi emëror*,
- *grupi foljor*,

- grupi mbiemëror,
- grupi parafjalor,
- grupi ndajfoljor.

Në fjalorin teknik të sintaksës bashkëkohore termi grup tashmë është zëvendësuar plotësisht me termin *sintagmë*, pra, flitet për :

- **sintagmë emërore (SE)**, p.sh.: *djalë i sjellshëm, mik i vjetër, vajza e saj, im vëlla* etj.
- **sintagmë foljore (SF)**, p.sh.: *lexoj poezi, ujit lulet, mbjell pemë, vjel mollët, flas bukur* etj..
- **sintagmë mbiemërore (SM)**, p.sh.: *e dashur me të tjerët, i rreptë për dietë* etj.
- **sintagmë parafjalore (SP)**, p.sh.: *në klasë, për peshk, nga bjeshkët shqiptare* etj.
- **sintagmë ndajfoljore (SN)**, p.sh.: *tepër shumë, fort mirë, mjaft bukur, krejt ngadalë* etj.

Këtë terminologji do të përdorim edhe këtu.

Kategoritë e mësipërme të sintagmave karakterizohen të gjitha nga një pjesë e caktuar e ligjëratës, përkatësisht nga: *emri, folja, mbiemri, parafjala* dhe *ndajfolja*. Kjo pjesë ligjëratare, karakteristike dhe themelore për përbërësit, quhet **kokë** e sintagmës. Kështu, koka e sintagmës emërore është emri, ajo e sintagmës foljore folja, e sintagmës mbiemërore mbiemri, e sintagmës parafjalore parafjala etj.. Koka është i vetmi element që duhet të shfaqet detyrimisht në çdo përbërës të një kategorie të caktuar.

Nëse koka shoqërohet nga elemente të tjera, kjo varet nga klasa leksikore së cilës i përket koka. P.sh, një sintagmë foljore, koka e së cilës është folje kalimtare, do të mbajë detyrimisht një sintagmë emërore e kështu me radhë.

LIDHJE DHE MARRËDHËNIE TË PËRBËRËSVE

1. *Marrëdhëniet kuptimore dhe lidhjet sintaksore midis përbërësve në sintagma.*
2. *Paraqitja e strukturave të frazave në sintagma*

1. Marrëdhëniet kuptimore dhe lidhjet sintaksore midis përbërësve në sintagma.

Midis përbërësve të sintagmave vendosen raporte të ndryshme kuptimore. Këto mund të jenë:

- **marrëdhënie përcaktore**. Janë ato marrëdhënie që vendosen midis sendit dhe tiparit a cilësisë së tij : erë *e lehtë*, maja *e Deçiçit*, çaj *mali*, bukë *misri*, fjala *e shqiptarit*, vajzë *besnike* etj.;
- **marrëdhëniet kundrinore** (objektore). Janë ato marrëdhënie që vendosen midis veprimit dhe objektit të tij: shoh *ndeshjen*, i shkruaj *letër motrës*, përshëndes *mësuesit*, nderoj *prindërit* etj.;
- **marrëdhënie rrethanore**. Janë ato marrëdhënie që vendosen midis veprimit dhe rrethanave në të cilat kryhet ai (vendore, kohore, shkakore, mënyrore, qëllimore, sasiore): shkruaj *me kujdes*, ha *shpejt*, i ardhur *nga larg* etj..

Përveç marrëdhënieve kuptimore, midis përbërësve në një sintagmë vendosen edhe *lidhje të ndryshme sintaksore*. Lloji i lidhjes sintaksore midis përbërësve përcaktohet nga natyra leksiko - gramatikore e kokës së sintagmës. Kështu, sipas llojit të lidhjes që vendos fjala përcaktuese me kokën e sintagmës, kemi lidhje me *përshtatje*, me *drejtim* me *bashkim*.

- **Lidhje me përshtatje** kemi atëherë kur gjymtyra përcaktuese merr kategoritë gramatikore të gjymtyrës që përcakton, d.m.th., të kokës së sintagmës. P.sh., në sintagmën *vend i bukur*, mbiemri merr gjininë, numrin dhe rasën e emrit që është kokë e sintagmës. Po të ndryshojmë kuptimet gramatikore të emrit, ndryshon edhe mbiemri: *vende të bukura*, (*i, e*) *vendeve të bukura*. Po kështu, po të ndryshojë edhe gjinia, mbiemri do të marrë gjininë e emrit me të cilin shkon: *vend i bukur*, *fushë e bukur*, *fushë*

pjellore, sjellje e këndshme etj.. Pra, kur gjymtyra përcaktuese përshtatet me gjymtyrën që përcakton.

- **Lidhje me drejtim** kemi kur fjala përcaktuese vihet në rasën që e kërkon koka e sintagmës, pra, koka drejton rasën e fjalës së varur. Drejtimi mund të jetë i fortë ose i dobët. Kemi *drejtim të fortë* kur fjala përcaktuese është e domosdoshme për kokën e sintagmës, pa të ajo s' mund të qëndrojë. Kjo ndodh në përgjithësi me foljet kalimtare të drejta dhe të zhdrejta, ato kanë nevojë për një emër në funksion të kundrinorit të drejtë ose të zhdrejtë, p.sh.: *shkruaj letër, pastroj dhomën, hap derën, ngroh gjellën, i hipi kalit* etj.
- **Lidhje me bashkim** kemi atëherë kur fjala përcaktuese e sintagmës është fjalë e pandryshueshme dhe vetëm sa i pranëvitet kokës së sintagmës. Varësia e fjalës nga koka e sintagmës nuk shprehet gramatikisht, përderisa është një pjesë ligjërata e pandryshueshme. Në të tilla lidhje hyjnë në sintagma ndajfoljet, format e pashtjelluara foljore, disa përemra, numërorët e ndonjë tjetër, si : *flas bukur, ha shpejt, dëshira përtë mësuar, gjashtë studentë* etj..


2. Paraqitja e strukturave të frazave në sintagma

Pamë më lart se frazat nuk analizohen si bashkime të thjeshta fjalësh, por janë të përbëra nga sintagma, të cilat, nga ana e tyre, mund të ndërtohen nga sintagma të tjera, deri te fjalët e fundit. Kjo tregon se frazat e gjuhëve natyrore kanë jo vetëm strukturë lineare, por edhe strukturë hierarkike. Më i njohuri dhe më i përhapuri ndër këto sisteme është ai ***i skemës së drurit***.


Duke qenë se fjalët grupohen në sintagma, mund të paraqesim treguesit semantikë të frazave të sipërpërmendura, që shënojnë përbërjen e tyre në sintagma dhe të këtyre të fundit në përbërës fundorë.

Skema e pemës është një mënyrë e mundshme për të paraqitur treguesin sintagmatik të një fraze ose hierarkinë e saj, si në skemat e fjalive të mëposhtme:


1.




2.



3.



4.



5.

